

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Practice**

B3

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 20.10.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Në disa organizata, është duke u kushtuar vëmendje mundësisë së kontraktimit të funksioneve të auditimit të brendshëm nga një palë e jashtme. Menaxhmenti në një organizatë të madhe duhet të pranojë se kontraktimi i auditorit të jashtëm për të kryer funksionin e auditimit të brendshëm mund të ketë një avantazh krahasuar me angazhimin e auditorit të brendshëm nga brenda stafit, për shkak se auditori i jashtëm:
- A. Njohja me organizatën. Auditimet e tij vjetore ofrojnë një njohuri të thellë të organizatës.
 - B. Madhësia. Ai/ajo mund të punësojë staf me përvojë, njohuri dhe me certifikim në auditim të brendshëm.
 - C. Madhësia. Ai/ajo është në gjendje të ofrojë disponueshmëri të vazhdueshme të stafit të pacënuar nga prioritetet e tjera.
 - D. Struktura. Mund të akomodojë më lehtë kërkesat e auditimit në vende të largëta.
2. Një kompani shërbimesh aktualisht po përjeton një zvogëlim të ndjeshëm dhe riorganizim të procesit. Bordi i drejtorëve ka ripërcaktuar qëllimet e biznesit dhe ka krijuar iniciativa duke përdorur teknologjinë e zhvilluar vet për të përmbushur këto qëllime. Si rezultat, është miratuar një qasje më decentralizuese për të drejtuar funksionet e biznesit duke fuqizuar menaxherët e degëve të biznesit për të marrë vendime dhe për të kryer funksione të kryera tradicionalisht në një nivel më të lartë. Stafi i auditimit të brendshëm përbëhet nga drejtori, dy menaxherët dhe pesë auditorë-staf, të gjithë me përvojë nga fusha e financave. Në të kaluarën, fokusi kryesor i aktiviteteve të suksesshme të auditimit ka qenë dega e shërbimeve dhe gjashtë selitë rajonale të departamenteve, të cilat mbështesin degët. Këto seli të departamenteve janë objektivat kryesore për eliminimin e mundshëm. Funksionet mbështetëse, siç janë burimet njerëzore, kontabiliteti dhe blerja, do të sjellen në selinë kombëtare dhe teknologjia do të avancohet për të mundësuar dhe shtuar këto operacione. Menaxherët e degëve e shohin funksionin e auditimit të brendshëm si një rojtar i menaxhmentit të lartë. Cila është mënyra më e mirë për auditimit të brendshëm për të ndryshuar nga kjo pikëpamje në atë se është më bashkëpunues?
- A. Rritja e fokusit në përgjegjësitë e kontrollit.
 - B. Rritja e aftësive teknike.
 - C. Rritja e konfidencialitetit të auditimeve hetimore për të minimizuar frikën.
 - D. Rritja e kërkesës për shqetësimet e të audituarit.
3. Komiteti i auditimit duhet të jetë krijuar në mënyrë të tillë që të përforcojë pavarësinë, edhe të funksioneve të kontrollit të brendshëm, edhe të atij të jashtëm dhe të izolojë funksionet e auditimit nga presionet e panevojshme të menaxhmentit. Duke përdorur këto kriterë, komitetet e auditimit duhet të përbëhen nga:
- A. Një nën-komitë i bordit të drejtorëve ose i ekuivalentit të tij, me anëtarë që qarkullojnë shpesh
 - B. Vetëm nga anëtarët e agjencive përkatëse rregullatore të jashtme.
 - C. Anëtarë nga të gjitha zonat e rëndësishme, duke përfshirë specifikisht përfaqësues nga bankat, agjencitë rregullatore të punës, aksionarët dhe nëpunësit.
 - D. Vetëm nga anëtarët e jashtëm të bordit të drejtorëve ose ekuivalenti i tij.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

4. Komitetet e auditimit identifikohen si një faktor domethënës për promovimin e pavarësisë edhe të auditorit të brendshëm edhe të atij të jashtëm. Cila nga elementet e mëposhtme është kufizimi më i rëndësishëm mbi efektivitetin e komiteteve të auditimit?
- A. Komitetet e auditimit mund përbëhen nga drejtorë të pavarur. Megjithatë, këta drejtorë mund të kenë miqësi të ngushta personale dhe profesionale me menaxhmentin.
 - B. Anëtarët e komitetit të auditimit kompensohen nga organizata dhe në këtë mënyrë favorizojnë pikëpamjen e pronarëve të aksioneve.
 - C. Komitetet e Auditimit pjesën më të madhe të përpjekjeve të tyre ia kushtojnë çështjeve të auditimit të jashtëm dhe nuk i kushtojnë edhe shumë vëmendje auditimit të brendshëm dhe mjedisit të përgjithshëm të kontrollit.
 - D. Anëtarët e komitetit të auditimit normalisht nuk janë diplomuar në fushat e kontabilitetit ose të auditimit.
5. Drejtori i auditimit të brendshëm i një kompanie shumëkombëshe duhet të formojë një ekip të auditimit për të kontrolluar një filial në një vend tjetër të sapo blerë. Cilët nga faktorët e mëposhtëm duhet të mirren në konsideratë?
- I. Zakonet lokale.
 - II. Aftësitë gjuhësore të auditorit.
 - III. Përvoja e auditorit.
 - IV. Kursi i këmbimit valutor.
- A. I, II, dhe III.
 - B. II, III dhe IV.
 - C. I dhe III.
 - D. I dhe II.
6. Gjatë një auditimi, auditori i brendshëm gjeti një skemë në të cilën drejtori i depos dhe agjenti i blerjes në një organizatë të shitjes me pakicë ia ndërruan drejtimin për në depon e tyre mallrave në vlerë rreth 500,000 dollarë dhe pastaj i shitën këto mallra palëve të treta. Mashtrimi nuk ishte zbuluar më parë për shkak se drejtori i depos i kishte dërguar fletpranimet e mallit (pas përditësimit të regjistrave të përhershëm të stokeve) në departamentin e llogarive të pagueshme për procesim. Supozoni se autorët e mashtrimit u rrëfyen tek auditori. Cili është veprimi i duhur nga ana e auditorit?
- A. Kërkoni që autorët e mashtrimit të nënshkruajnë përmblendhjen e auditorit për rrëfimin dhe përfshijeni këtë në letrat e punës. Raportoni detajet pastaj tek menaxhmenti i lartë për veprime të mëtutjeshme.
 - B. Hiqeni dokumentacionin nga letrat e punës sepse është subjektiv, i ndjeshëm dhe mund të bëhet dëshmi ligjore. Raportoni detajet tek menaxhmenti dhe kërkoni që ata të kërkojnë këshillë ligjore për të dokumentuar rrëfimin.
 - C. Raportoni gojarisht rrëfimin tek menaxhmenti dhe sugjeroni që ata t'ia raportojnë atë autoriteteve ligjore, për shkak se është përfshirë një krim. Mos e dokumentoni.
 - D. Informoni autorët e mashtrimit për të drejtat e tyre, dokumentoni rrëfimin e tyre përmes inqizimit dhe informoni autoritetet lokale ligjore për krimin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

7. Në disa kultura dhe organizata, menaxherët insistojnë se funksioni i auditimit të brendshëm nuk është i nevojshëm për të siguruar një vlerësim kritik të operacioneve të organizatës. Një qëndrim i tillë i menaxhmentit me mundësi të madhe do të ketë një ndikim negativ mbi njërin nga elementet e mëposhtme të departamentit të auditimit të brendshëm, i cili është:

- A. Variancat operative të buxhetit
- B. Statuti.**
- C. Vlerësimet e performancës.
- D. Politikat dhe procedurat.

8. Menaxhmenti pohoi se standardet e performancës që auditorët përdorën për të vlerësuar performancën operative ishin të papërshtatshme. Standardet e shkruara të performancës që ishin krijuar nga menaxhmenti ishin të paqarta dhe duhej të interpretoheshin nga auditori. Në raste të tilla, auditorët mund të përmbushin përgjegjësinë e tyre për kujdesin e duhur:

- A. Duke u siguruar që interpretimet e tyre janë të arsyeshme.
- B. Duke u siguruar që interpretimet e tyre janë në përputhje me praktikat e industrisë.
- C. Duke krijuar marrëveshje me të audituarin sa i përket standardeve të nevojshme për të matur performancën.**
- D. Duke përfshirë kundërshtimet e menaxhmentit në raportin e auditimit.

9. Një organizatë e shitjes me pakicë sapo ka implementuar shkëmbimin elektronik të të dhënave (EDI) për të lëshuar urdhërblerja për furnitorët kryesorë. Zhvilluesi i sistemit ka zhvilluar një bazë të dhënash të furnitorëve të miratuar. Furnitorët e rinj mund të shtohen vetëm pas një rishikimi të hollësishtë nga menaxheri i blerjeve dhe drejtori i marketingut. Vetëm agjentët e blerjeve mund të lëshojnë urdhërblerja dhe shuma e urdhërblerjeve për një linjë të caktuar produktesh nuk mund të kalojë shumën e buxhetuar të përcaktuar nga menaxheri i marketingut.

Të gjitha blerjet shkojnë në qendrën e shpërndarjes, ku skanohen elektronikisht në sistemin kompjuterik. Të gjithë artikujt hyrës duhet t'i referohen urdhërblerjes së kompanisë dhe artikujt që nuk përmbajnë një referencë të tillë nuk pranohen. Nuk përdoren fletëpranimet me numër të paracaktuar, por të gjitha faturat i referohen urdhër blerjes. Etiketat e çmimit gjenerohen sipas porosisë së blerjes dhe për sasi të shënuara në raportin e pranimi elektronik të skanuar. Numri i etiketave të krijuara të çmimeve përputhet me numrin e produkteve të marra.

Furnitori dërgon një faturë tek shitësi me pakicë. Faturat regjistrohen në sistem. Softueri kompjuterik është i programuar që të përputhe faturën e furnitorit, urdhër blerjen dhe raportin e pranimi. Nëse të tre këto dokumente përputhen brenda një tolerance prej 0.5%, programi kompjuterik i planifikon artikujt për pagesë brenda kohës për të përfituar nga zbritjet në blerje. Çeku gjenerohet nga programi i pagesave me para të gatshme dhe nënshkruhet e dërgohet me e-mail në formë elektronike. Nëse ka një mospërputhje midis të tre dokumenteve, shtypet një raport i cili i dërgohet departamentit të llogarive të pagueshme për hetim.

Procedura më e mirë për të përcaktuar nëse procedura e kontrollit për të kufizuar sasinë e blerjeve për një linjë produktesh të veçantë, ishte duke funksionuar siç duhet gjatë vitit të kaluar, do të ishte:

- A. Përdorimi i softuerit të përgjithësuar të auditimit për të përgatitur një listë të blerjeve sipas linjës së produktit. Krahasoni shumat e blera me shumat e autorizuara nga menaxheri i marketingut.**
- B. Paraqitja e të dhënave testuese në programin që kontrollon blerjet. (Shuma e të dhënave hyrëse duhet të kalojë blerjet e autorizuara.) Shqyrtoni rezultatet e nxjerra nga kompjuteri.
- C. Përdorimi i teknikave paralele të simulimit për të llogaritur shumën e blerjeve të autorizuara dhe krahasimi atë shumë me shumën e blerë në të vërtetë.
- D. Zbatimi i një qasje të auditimit të çastit, i cili do të shënojë transaksionet e përzgjedhura dhe printimi i atyre së bashku me një listë të artikujve të rregulluar nga agjenti blerës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

10. Cila nga të mëposhtmet nuk ka gjasa të përfshihet si një hap i auditimit kur vlerëson politikat e performancës së furnizuesit?
- A. Përcaktimi nëse furnizuesi ka dërguar madhësi të rëna dakord.
 - B. Përcaktimi nëse janë marrë vetëm artikujt e autorizuar nga furnizuesi.
 - C. Përcaktimi nëse saldot që i detyrohen furnizuesit janë të sakta.
 - D. Përcaktimi nëse cilësia e mallrave të blera nga furnizuesi ka qenë e kënaqshme.
11. Auditori i brendshëm është përgjegjës për raportimin e mashtrimit tek menaxhmenti i lartë ose bordi kur:
- A. Me një siguri të arsyeshme janë përcaktuar shumat materiale të rastit të mashtrimit.
 - B. Aktivitete të dyshimta janë raportuar në auditimin e brendshëm.
 - C. Transaksionet e parregullta janë identifikuar dhe janë nën hetim.
 - D. Rishikimi i të gjitha transaksioneve të dyshuara për mashtrim është përfunduar.
12. Në përgjithësi nuk ka incentiva për efikasitet apo ekonomi në një kontratë ndërtimi kosto-plus për projekte të vogla dhe unike. Ekziston një potencial për shpenzime të fryra. Një kontroll i përshtatshëm për të inkurajuar efikasitetin dhe ekonominë në këto kontrata është:
- A. Eliminimi i urdhëresave të ndryshuara në kontratë.
 - B. Vendosja e masave për shpenzime maksimale dhe ndarja e kursimeve në kosto.
 - C. Përdorimi i një çmimi të rënë dakord për çdo njësi të punës.
 - D. Përdorimi i qasjes së listës së kontrollit për auditimin e kostove të kontratës.
13. Një universitet është duke e parë si jopraktike të ketë një funksion të centralizuar të pranimin për blerjet e departamentit për libra, furnizime dhe pajisjeve. Cila nga kontrollet në vijim do të parandalonte më efektivisht pagesën për mallrat që nuk janë marrë, nëse kontrolla kryhet para se të ekzekutohet pagesa e faturës?
- A. Faturat e furnitorit duhet të përputhen me urdhër-bletjet e departamenteve.
 - B. Emrat dhe adresat e furnitorëve të paraqitur në fatura duhet të krahasohen me një listë të furnitorëve të autorizuar nga departamenti.
 - C. Mbikëqyrësi i departamentit, i ndryshëm nga punonjësi i cili i porosit mallrat, duhet të miratojë faturat e furnitorit.
 - D. Zëvendës-shefi i i financave duhet të miratojë faturat mbi një shumë të caktuar.
14. Gjatë auditimit të departamentit të blerjes së një kompanie, një auditor i brendshëm zbuloi se shumë blerje ishin bërë (me çmime normale) nga një firmë për furnizimin e zyreve, pronari i të cilit ishte vëllai i drejtorit të blerjes. Nuk kishte politika ose kontrolle për të kufizuar blerjet e tilla dhe nuk duket se ka ndodh ndonjë mashtrim. Në këtë rast, auditori i brendshëm duhet të rekomandojë:
- A. Zhvillimin e një dosje të furnitorëve të miratuar të iniciuar nga blerësi dhe të miratuar nga drejtori i blerjes.
 - B. Vendosjen e një politike të rangut të çmimeve për të gjitha mallrat.
 - C. Fillimin e aplikimit të një politike të konfliktit të interesit.
 - D. Inspektimin e të gjitha pranimeve nga inspektorët pranues.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

15. Një auditor shqyrtoi sigurinë e qasjes në aplikacionet e ndryshme kompjuterike të kompanisë. Auditori gjeti se siguria përbëhej nga kontrollet e hyrjes të programuara në çdo aplikacion kompjuterik. Rekomandimi më i mirë në këtë situatë, për menaxhmentin, është:
- A. Eliminimi i kontroleve të integruara të qasjes.
 - B. Konsiderimi i përdorimit të softuerit të kontrollit të qasjes.
 - C. Konsiderimi i përdorimit të softuerit të shërbimeve.
 - D. Zgjerimi i përdorimit të kontroleve të integruara të qasjes në aplikacione të reja.
16. Një organizatë shet produkte nëpërmjet katalogut dhe merr porosi nëpërmjet telefonit. Të gjitha urdhresat e porosive regjistrohen online dhe objektivi i organizatës është të dërgojë të gjitha porositë brenda 24 orëve. Gjurmët e transaksioneve mbahen në formë të lexueshme në makinë. Ddokumentet e vetme të gjeneruara janë fletëpaketimet dhe faturat e dërguar tek klienti. Të hyrat regjistrohen në kohën e dërgimit të mallrave. Organizata mban një databazë të hollësishme të konsumatorëve që iu lejon konsumatorëve të kthejnë mallrat në çdo kohë.
- Auditori dëshiron të përcaktojë se vetëm menaxheri i marketingut dhe personeli tjetër i caktuar në departament kanë miratuar ndryshime në çmimin e produkteve në databazën e produktit. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ofrojë dëshmi më bindëse mbi efektivitetin e kontrollit lidhur me ndryshimet e çmimeve?
- A. Përdorimi i një strukture të integruar testimi (ITF) dhe dorëzimi i porosive të produktit në ITF. Krahasimi i çmimeve të faturuara me çmimet në katalogun e fundit.
 - B. Përdorimi i teknikës së auditimit 'Sistemi i kontrollit të dosjeve të rishikuara të auditimit' (SCARF) për të krijuar një listë të të gjitha porosive të klientëve që tejkalojnë kufirin e përcaktuar shumë në euro dhe printimi i rezultateve për hetime të mëtejshme.
 - C. Marrja e një kopje të të gjitha ndryshimeve të autorizuara të çmimeve dhe gjurmimi manual në edicionin aktual të katalogut të organizatës.
 - D. Marrja e një regjistri të kompjuterizuar të të gjitha ndryshimeve të bëra në databazën e çmimeve. Marrja e një mostre të rastësishme të ndryshimeve dhe gjurmimi deri tek dokumenti i nënshkruar nga personi që autorizon ndryshimin.
17. Qëllimi kryesor i studimit dhe vlerësimit të operacioneve të teknologjisë informative (TI) të kompanisë nga auditori i brendshëm, është që:
- A. Të vlerësoj kompetencën e personelit operativ të TI.
 - B. Të siguroj ushtrimin e kujdesit të duhur profesional.
 - C. Të vlerësoj besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe operativ.
 - D. Të familjarizohet me mjetet e kompanisë për identifikimin, matjen, klasifikimin dhe raportimin e informacionit.
18. Një auditor i brendshëm është duke përgatitur procedurat për të verifikuar integritetin e të dhënave në një aplikacion të bazës së të dhënave. Burimi më i mirë i informacionit për auditorin për të përcaktuar përkufizimet e fushave të të dhënave është:
- A. Nën-skemat e të dhënave.
 - B. Fjalori i të dhënave.
 - C. Gjuha e përkufizimit të të dhënave.
 - D. Gjuha e manipulimit të të dhënave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

19. Një kompani shumëkombëshe ka një marrëveshje me një rrjet të vlerës së shtuar (VAN) që siguron kodimin dhe transferimin e komunikimit për këmbimin elektronik të të dhënave të kompanisë (EDI) dhe transferimin elektronik të fondeve (EFT). Para transferimit të të dhënave në rrjetin e vlerës së shtuar, kompania kryen përpunimin paraprak online të transaksioneve. Auditori i brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e kontrolleve të përpunimit paraprak. Përveç kësaj, marrëveshja ndërmjet kompanisë dhe rrjetit të vlerës së shtuar thekson se auditorit të brendshëm i lejohet të kontrolloj dhe raportoj mbi kontrollet ekzistuese (të vendosura) në rrjetin e vlerës së shtuar në baza vjetore. Kontrata specifikon se qasja në rrjetin e vlerës së shtuar mund të ndodhë papritur, gjatë tremujorit të dytë ose të tretë të vitit fiskal të kompanisë. Kjo periudhë është zgjedhur kështu për shkak se nuk do të ndërhynte në përpunimin gjatë periudhave të transaksioneve kulmore të rrjetit të vlerës së shtuar. Kjo dispozitë nuk është shqyrtuar me auditimin e brendshëm. Plani vjetor i auditimit i miratuar nga bordi i drejtorëve specifikon se një auditim i plotë do të bëhet gjatë vitit aktual.

Cila nga kontrollet në vijim të përpunimit paraprak ka më së paku të ngjarë se do t'i ofroj auditorit siguri në lidhje me vlefshmërinë e transaksioneve?

- A. Verifikimi i kërkuarit.
- B. Autentifikimi i informacionit.
- C. Procesimi i përjashtimeve.
- D. Dekriptimi i të dhënave.

20. Cila nga aktivitetet e mëposhtme audituese (për t'u audituar) paraqet rrezikun më të madh për një korporatë prodhuese të sapo bashkuar dhe si rrjedhojë ka gjasa që të jetë subjekt i një auditimi?

- A. Kombinimi i fondeve të parave të gatshme.
- B. Kombinimi i funksioneve blerëse.
- C. Kombinimi i funksioneve ligjore.
- D. Kombinimi i funksioneve të marketingut.

21. Faza e parë e procesit të vlerësimit të rrezikut është identifikimi dhe katalogimi i aktiviteteve audituese (për t'u audituar) të organizatës. Cila nga të mëposhtmet nuk do të konsiderohet si një aktivitet që duhet të auditohet?

- A. Agjenda e zhvilluar nga komiteti i auditimit për njërin nga takimet e tyre tremujore.
- B. Saldot e llogarive të librit të madh (kryesor).
- C. Sistemet kompjuterike të informacionit.
- D. Ligjet dhe rregulloret që ndikojnë në organizatë.

22. Cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan një studim paraprak?

- A. Një pyetësor i standardizuar i përdorur për të kuptuar objektivat e menaxhmentit.
- B. Një mostër statistikore e qëndrimeve, aftësive dhe njohurive të punonjësve kryesorë.
- C. Një kalim përmes sistemit të kontrollit financiar për të identifikuar rreziqet dhe kontrollet që mund t'i adresojnë këto rreziqe.
- D. Një proces i përdorur për t'u familjarizuar me aktivitetet dhe rreziqet në mënyrë që të identifikohen fushat të cilave duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje gjatë auditimit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

23. Faktorët që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të rrezikut të auditimit në një fushë funksionale përfshijnë:

- I. Vëllimin e transaksioneve.
- II. Shkallen e integritetit të sistemit.
- III. Vitet, që nga auditimi i fundit.
- IV. Qarkullimi i konsiderueshëm i menaxhmentit.
- V. Vlera në euro e "pasurive në rrezik".
- VI. Vlera mesatare për transaksion.
- VII. Rezultatet e auditimit të fundit.

Faktorët që përcaktojnë më së miri materialitetin e rrezikut të auditimit janë:

- A. 1 deri në 7.
- B. 2, 4 dhe 7.
- C. 1, 5 dhe 6.
- D. 3, 4 dhe 6.

24. Standardet IIA i kërkojnë auditorëve të diskutojnë përfundimet dhe rekomandimet me nivelet e duhura të menaxhmentit para lëshimit të raporteve përfundimtare me shkrim. Auditorët zakonisht e realizojnë këtë duke zhvilluar konferenca të daljes. Cili nga elementet e mëposhtme përshkruan më mirë qëllimin e konferencave të daljes?

- A. I lejojnë të audituarve të fillojnë vënien në zbatim të rekomandimeve sa më shpejt të jetë e mundur.
- B. I lejon auditorëve të shpjegojnë gjetjet e ndërlikuara para se të lëshohet një raport me shkrim
- C. I lejon auditorëve për të 'shesin' gjetjet dhe rekomandimet ndaj menaxhmentit
- D. Bën të sigurt se nuk ka pasur keqkuptime ose keqinterpretime të fakteve

25. Auditimi i funksionit të automatizuara të llogarive të arkëtueshëm për një kompani të prodhimit të mobiljeve, sapo është përfunduar. Gjetjet e rëndësishme përfshijnë regjistrimin e vonuar të pagesave të klientëve, dërgimin me vonesë të faturave mujore dhe ndjekjen e parregullt të llogarive të arkëtueshme të cilave ju ka kaluar afati për pagesë. Cilët nga menaxherët e mëposhtëm duhet të marrin pjesë në konferencën e daljes për këtë auditim?

- A. Drejtori i auditimit të brendshëm, zyrtari kryesor operativ dhe kontabilisti.
- B. Udhëheqësi i ekipit të auditimit, kontabilisti dhe zëvendës-menaxheri i sistemeve të informacionit.
- C. Udhëheqësi i ekipit të auditimit, menaxher i departamentit të llogarive të arkëtueshme dhe menaxher i departamentit të përpunimit të të dhënave.
- D. Drejtori i auditimit të brendshëm, udhëheqësi i financave, drejtori ekzekutiv dhe zëvendës-menaxheri i sistemeve të informacionit.

26. Programi i auditimit për një auditim të plotë të funksionit të blerjes, duhet të përfshijë:

- A. Hapat e punës të rregulluar sipas prioritetit relativ bazuar në rrezikun e perceptuar.
- B. Deklaratën e objektivave të auditimit të operacioneve nën shqyrtim me marrëveshje nga ana e të audituarit.
- C. Metodatat specifike për realizimin e objektivave të auditimit.
- D. Një fokus në rreziqet që ndikojnë në pasqyrat financiare në krahasim me kontrollet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

27. Një auditor i brendshëm është angazhuar për të kryer auditimin e programit të sigurimeve të kompanisë, duke përfshirë përshtatshmërinë e qasjes për të minimizuar rreziqet ndaj kompanisë. Kompania vetësiguron humbjet e mëdha nga fatkeqësitë dhe u ofron të gjithë punonjësve të saj përfitime shëndetësore. Kompania është një firmë e madhe kombëtare me mbi 15,000 punonjës të vendosur në pjesë të ndryshme të vendit. Ajo përdor një procesor të jashtëm për të administruar programin e kujdesit shëndetësor. Shpenzimet mjekësore të kompanisë janë rritur me rreth 8% në vit për pesë vitet e fundit dhe menaxhmenti është i shqetësuar për kontrollin e tyre.

Supozoni që auditori dëshiron të testoj nëse procesori i kujdesit shëndetësor është duke përmbushur kërkesat e kontratës në lidhje me pagesën e duhur ose mohimin e kërkesave të punonjësve. Qasja më e mirë e auditimit do të ishte marrja e një mostre të:

- A. Punonjësve dhe intervistimi në lidhje me përvojat e tyre shëndetësore, nëse pagesa ishte e duhur dhe me kohë nga procesori i kujdesit shëndetësor.
- B. Kërkesave të paguara nga procesori i kujdesit shëndetësor dhe përcaktimi nëse të gjitha pagesat ishin të duhura.
- C. Kërkesave të paraqitura tek procesori i kujdesit shëndetësor dhe përcaktimi nëse ato janë paguar apo nëse janë mohuar siç duhet.
- D. Kërkesave të paguara nga procesori i kujdesit shëndetësor dhe angazhimi i një eksperti të jashtëm për të analizuar nëse kërkesat janë përpunuar në mënyrë të përshtatshme.

28. Dokumentet e punës duhet të përfshijnë:

- A. Dokumentimin e ekzaminimit dhe vlerësimit të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- B. Kopjet e të gjitha dokumenteve burimore të shqyrtuara gjatë auditimit.
- C. Kopjet e të gjitha procedurave që janë shqyrtuar gjatë auditimit.
- D. Të gjitha dokumentet e punës të përgatitura gjatë një auditimi të mëparshëm të së njëjtës zonë.

29. Një auditor i brendshëm ka kryer një studim paraprak dhe ka identifikuar një numër çështjesh të rëndësishme të auditimit dhe arsyet për ndjekjen e tyre më në thellësi. I audituari e informon në mënyrë joformale pajtueshmërinë me rezultatet e studimit paraprak dhe kërkon nga auditori të mos raportojë për fushat me interes të rëndësishëm derisa i audituari të ketë një mundësi për t'u përgjigjur në fushat problematike. Cila nga përgjigjet e mëposhtme të auditorit nuk do të ishte e përshtatshme?

- A. Vazhdimi i auditimit sipas planit të auditimit dhe diskutimi me menaxhmentin për nevojën e përfundimit të auditimit në kohën e duhur.
- B. Konsiderimi i rrezikut në fushat e përfshira dhe nëse rreziku është i lartë, vazhdimi me auditimin.
- C. Konsiderimi i faktit që auditimi të përfundojë pa ndonjë raport pasi që i audituari ka rënë dakord të ndër marrë veprime konstruktive.
- D. Vazhdimi i punës me të audituarin për të mbajtur auditimin brenda afatit dhe adresimi i çështjeve të rëndësishme dhe përgjigjeve të të audituarit më në thellësi, gjatë auditimit.

30. Gjatë përcaktimit të periudhës së mbajtjes së dokumenteve të punës së auditimit të kontraktuar, është më mirë që të:

- A. Shqyrtoni manualin e politikave të korporatës të zhvilluar nga menaxhmenti i regjistrave, konkretisht seksionin lidhur me regjistrat e biznesit.
- B. Kërkoni ndihmën e departamentit ligjor për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat e kontratës.
- C. Verifikoni së bashku me departamentin e kontabilitetit të korporatës pasi që të dhënat e kontabilitetit janë të përfshira.
- D. Ndiqni politikat e brendshme të të kontraktuesit për ruajtjen e regjistrave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

31. Një mbikëqyrës i auditimit të brendshëm, ndërsa rishikonte letrat e punës të përpiluara nga një anëtar i personelit të auditimit, identifikoi një deklaratë të pa – mbështetur që njësia e audituar ushtronte veprimtarinë në mënyrë jo – efektive. Cili nga elementet e mëposhtme tregon veprimin që duhet të marrë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i auditorit?
- A. Largimi i komentit nga dosja ose skeda e letrave të punës.
 - B. Përfundimi i pëlqimit të të audituarit për sa i takon këtij pohimi.
 - C. Hulumtimi dhe identifikimi i kriterëve për matjen e efikasitetit operativ.
 - D. Shpjegimi i faktit se ky është thjeshtë mendimi i anëtarit të personelit.
32. Cila nga teknikat e mëposhtme është më e mira për të theksuar një çështje të caktuar gjatë një komunikimi me shkrim?
- A. Çështja duhet të vendoset në mes të paragrafit dhe jo në fillim ose në fund të tij.
 - B. Përdorimi i foljeve jo – veprorë në vend të atyre veprorë.
 - C. Nxjerrja në pah e çështjes duke përdorur struktura jo – paralele.
 - D. Përdorimi i një fjalie të shkurtër me një ide, në vend të një fjalie të gjatë që përmban disa ide
33. Një kompani kohët e fundit përjetoi një reduktim të ndjeshëm në fitimin neto nga shitjet e linjës A. Linja A është prodhuar në një makinë të dedikuar për të. Auditorëve të brendshëm iu është caktuar detyra e përcaktimit të shkakut të reduktimit të fitimit neto. Si hap i parë, auditori i ngarkuar duhet të:
- A. Testoj vlefshmërinë e blerjeve të materialeve.
 - B. Vlerësoj elementet e kostos dhe t'i krahasoj ato me periudhat e mëparshme.
 - C. Krahasoj të dhënat e prodhimit me kostot standarde.
 - D. Analizoj mbeturinat dhe të dhënat e tepërta.
34. Raporti i auditimit në lidhje me një auditim të një banke kategorizon gjetjet në "gjetjet e mungesës" për probleme të mëdha dhe "fusha të tjera për përmirësim" për probleme më pak serioze. Cila nga fragmentet në vijim do të përfshihej në kategorinë "fusha të tjera për përmirësim"?
- A. Shumë kredi të siguruara nuk përmbanin mbulim të sigurimit të rrezikut për kolateralin e pasurive të prekshme.
 - B. Zyrtarët e kredive gjithashtu përgatisin çeqet e arkës për pagesën e kësteve të kredisë.
 - C. Banka është duke shkaktuar kosto të panevojshme të postës duke mos i kombinuar disa postime të posaçme për të kontrolluar klientët e llogarisë me postimet mujore të deklaratave të tyre.
 - D. Në një degë një sasi e madhe e parave të gatshme u vendos në një tavolinë lehtë të qasshme prapa linjave treguese.
35. Një auditor i brendshëm mund të përdorë raportet verbale (me gojë) për të:
- A. Dhënë informacion të menjëhershëm për menaxhmentin dhe shkëmbimin më të mirë të mendimeve në një diskutim ballë për ballë.
 - B. Raportuar rezultatet e auditimit të ndërmjetëm në mënyrë më efektive duke eliminuar kohën e përgatitjes të një raporti me shkrim.
 - C. Eliminuar nevojën për një raport të gjatë përfundimtar, duke arritur marrëveshje verbale për trajtimin e gjetjeve të rëndësishme me të audituarin.
 - D. Impresionuar të audituarin me një prezantim të sofistikuar duke përdorur grafikë për të rritur kredibilitetin e gjetjeve të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

36. Një auditim i departamentit të pagave të një kompanie ka zbuluar dobësi të ndryshme të kontrollit. Këto dobësi së bashku me rekomandimet për veprime korrigjuese janë adresuar në raportin e auditimit të brendshëm. Ky raport duhet të jetë më i dobishmi për:
- A. Thesaristin e kompanisë.
 - B. Komitetin e auditimit të bordit të drejtorëve të kompanisë.
 - C. Menaxherin e pagave të kompanisë.
 - D. Kryetarin e kompanisë.
37. Një anëtar i lartë i menaxhmentit, i cili është disa nivele më lart se udhëheqësi i fushës operationale që po auditohet, ka kërkuar një raport të gjetjeve të auditimit. Mjeti më i përshtatshëm i komunikimit të gjetjeve të auditimit me këtë anëtar të lartë të menaxhimit është:
- A. Dërgimi i një kopje të raportit përfundimtar të auditimit.
 - B. Komunikimi me gojë i gjetjeve.
 - C. Dërgimi i kopjeve të raporteve të ndërmjetme.
 - D. Dërgimi i seksionit përmbledhës të raportit.
38. Një ekstrakt nga një gjetje e auditimit tregon se avancet e udhëtimit tejkalojnë shumën maksimale të parashikuara. Politika e kompanisë siguron fonde udhëtimi për punonjësit e autorizuar për udhëtime. Avancet nuk duhet të tejkalojnë 45 ditë të shpenzimeve të parashikuara. Procedurat e kompanisë nuk kërkojnë justifikime për avancet e mëdha të udhëtimit. Punonjësit mund dhe e bëjnë akumulimin e avanceve të mëdha dhe të panevojshme. Cili është shkaku i kësaj gjetje?
- A. Procedurat e avancuara të kompanisë nuk kërkojnë arsytetime specifike.
 - B. Politikat e kompanisë sigurojnë fonde udhëtimi për punonjësit e autorizuar.
 - C. Punonjësit grumbullojnë avance të mëdha udhëtimi.
 - D. Avancet e udhëtimit nuk janë mbyllur në kohën e duhur.
39. Një gjetje e auditimit është formuluar si në vijim:
Buxheti kapital përfshin fonde për blerjen e 11 automjeteve të reja. Shqyrtimi i të dhënave të përdorimit tregoi se: 10 automjete në flotën e 70 automjeteve janë ngasur më pak se 4,000 kilometra gjatë vitit të kaluar. Automjetet iu janë caktuar grupeve të ndryshme, normat e përdorimit të të cilëve kanë ndryshuar shumë. Nuk kishte asnjë politikë që kërkon rotacionin e automjeteve midis grupeve të përdorimit të lartë dhe të ulët. Mungesa e kriterëve për caktimin e automjeteve si dhe mungesa e një sistemi për monitorimin e përdorimit të tyre mund të çojë në blerjen e automjeteve të panevojshme.
- Bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjetje, do të ishte e përshtatshme që të rekomandojmë që menaxhmenti duhet të:
- A. Vendosë një minimum prej 4,000 kilometrave për tremujor si kriter për caktimin e automjeteve tek grupet e përdoruesve.
 - B. Krijoj një sistem për qarkullimin e automjeteve midis përdoruesve në mënyrë periodike.
 - C. Vonoj blerjen e automjeteve të propozuara derisa kapaciteti i tepërt i dukshëm të shpjegohet ose zhvlerësohet në mënyrë adekuate.
 - D. Ndaloj miratimin e buxhetit kapital derisa projektet e tjera të mund të rishikohen nga auditimi i brendshëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

40. Udhëheqësi i ekipit të auditimit ka më pak të ngjarë të ketë rol parësor në:

- A. Alokimin e orëve të buxhetuara të auditimit ndërmjet stafit të caktuar.
- B. Përditësimin e dosjeve të përhershme.
- C. Rishikimin e dokumenteve të punës.
- D. Përgatitjen e fletës së kritikës për auditimin.

41. Duke pasur parasysh që iu është dhënë detyra e zhvillimit të një sistemi të vlerësimit të performancës për vlerësimin e performancës së auditimit të një stafi të madh të auditimit të brendshëm, ju duhet:
- A. Të jepni një shpjegim për metodat e kriterëve të vlerësimit në kohën kur rezultatet e vlerësimit diskutohen me auditorin e brendshëm.
 - B. Të jepni informacione të përgjithshme në lidhje me frekuencën e vlerësimeve dhe mënyrën se si do të kryhen vlerësimet pa specifikuar kohën dhe përdorimin e tyre.
 - C. Të siguroheni në radhë të parë për vlerësimin e kriterëve të tilla si kujdesi, iniciativa dhe taktika.
 - D. Të siguroheni kryesisht për vlerësimin e arritjeve specifike që lidhen drejtpërdrejt me performancën e programit të auditimit.
42. Anëtarëve të stafit të auditimit të brendshëm duhet t'u sigurohet një mjet i duhur përmes të cilit ata mund të diskutojnë problemet dhe të përditësohen në lidhje me politikat e departamenteve. Forumi më i përshtatshëm për këtë qëllim është:
- A. Linjat informale të komunikimit ndërmjet departamenteve.
 - B. Memorandume ndërdepartamentale.
 - C. Takimet e stafit.
 - D. Konferencat e vlerësimit të punonjësve.
43. Përparësia që i atribuohet krijimit të zyrave të auditimit të brendshëm për punë në vende të largëta përshkruhet më së miri si:
- A. Mundësi e rritjes së objektivitetit të personelit të caktuar në një zyrë në terren.
 - B. Një reduktim i kohës së udhëtimit dhe shpenzimeve të lidhura me udhëtimin.
 - C. Lehtësia në rritje e mbajtjes së standardeve uniforme të kompanisë.
 - D. Kontakte më të shumta me personelin e lartë të auditimit e cila çon në një rritje të kontrollit.
44. Një menaxher i auditimit të brendshëm ka një ekip të vogël punonjësish, por secili individ është i vetëmotivuar dhe mund të quhet një arritës (fitues) i lartë. Menaxherit të auditimit i është dhënë një detyrë veçanërisht e vështirë. Edhe për një arritës të lartë, probabiliteti që kjo punë mund të plotësohet nga një individ deri në afatin e kërkuar është e ulët. Zgjidhni ekipin më të mirë për menaxherin e auditimit.
- A. Caktoni një individ, pasi arritësit e lartë lulëzojnë në rreziqe të larta.
 - B. Caktoni dy anëtarë të stafit për të moderuar rrezikun e dështimit.
 - C. Caktoni të gjithë stafin për të siguruar se rreziku i dështimit është i ulët.
 - D. Kërkojini menaxhmentit të kompanisë që të anulojnë punën.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

45. Për shkak të dobësive të kontrollit, është e mundur që menxherët individualë të 122 restoranteve mund të kenë vendosur punonjës fiktivë në listën e pagave. Çdo restorant punëson 25-30 persona. Për të përcaktuar në mënyrë efikase nëse ky mashtrim ekziston në më pak se 1%, auditori duhet të përdorë:
- A. Mostrën sipas veçorive.
 - B. Mostrën sipas gjykimit.
 - C. Mostrën sipas drejtimit.
 - D. Mostrën për zbulim.
46. Një auditor i brendshëm dyshon për mashtrim. Cila nga planet e mëposhtme të mostrës duhet të përdoret nëse qëllimi është të përzgjedh një mostër me një probabilitet të caktuar që përmban të paktën një shembull të parregullsisë?
- A. Veçoritë.
 - B. Zbulimi.
 - C. Ndal dhe shko.
 - D. Probabiliteti proporcional me madhësinë.
47. Nga një këndvështrim i sigurisë kompjuterike, çfarë niveli të kujdesit presin gjykatat nga organizatat?
- A. Gjithë kujdesin e mundshëm.
 - B. Kujdesin e duhur.
 - C. Kujdesin e jashtëzakonshëm.
 - D. Kujdes të madh.
48. Sekuenca e saktë e hetimeve paraprake është:
- I. Konsultimi me një ekspert kompjuteri.
 - II. Përgatitja e një plani për hetime.
 - III. Konsultimi me një prokuror.
 - IV. Vërtetimi i pretendimeve.
- A. IV, I, II dhe III.
 - B. III, I, II dhe IV.
 - C. IV, II, III dhe I.
 - D. I, IV, II dhe III.
49. Në cilin moment është i nevojshëm një mandat për kërkime:
- A. Para se të jetë vërtetuar pretendimi.
 - B. Pas njohjes së shkakut ose shkaqeve të mundshme.
 - C. Para se të identifikohet numri i hetuesve të nevojshëm.
 - D. Pas konfiskimit të kompjuterit dhe të pajisjeve përkatëse.
50. Mashtrimi kompjuterik dekurajohet nga:
- A. Gatishmëria për t'e ndjekur penalisht.
 - B. Zhurmuesit e izoluar.
 - C. Joefikasiteti në sistemin gjyqësor.
 - D. Pranimi i mungesës së integritetit në sistem.